



NDIHMA JURIDIKE | PRAVNA POMOC  
LEGAL AID



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në mes të

**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS**

dhe

**AGJENSIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS**

Duke pranuar që:

- Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) ushtron përgjegjësinë parësore për ngritjen e standardeve të sjelljes etike të avokatëve - anëtarëve të saj, si dhe kryen hetimet disiplinore dhe dëgjimet administrative dhe lëshon vendime disiplinore për këtë qëllim,
- raportimi i kërkesës së bazuar për hetimet rreth sjelljes joetike ose joprofesionale të anëtarëve të OAK-së duhet të rishikohet dhe të hetohet nga OAK-ja, në mënyrë që të reduktohen rastet e sjelljes së keqe të avokatëve, për të trajtuar dhe për të parandaluar dëmet ndaj klientëve dhe publikut, dhe të ruhet reputacioni i profesionit ligjor,
- 6 zyrat rajonale të OAK-së që kanë qenë mbështetëse të publikut në kompletimin dhe marrjen e kërkesës së OAK-së për hetime disiplinore nuk do të vazhdojnë më me veprimtari, pasi që OAK-ja konservon burimet e veta për të zgjeruar kapacitetin e vet për hetime disiplinore përmes krijimit të Zyrës së saj të Prokurorit Disiplinor,
- institucioni publike dhe privat i ndihmës juridike, Agjensia për Ndihmë Juridike Falas – ANFJ, është e pozicionuar mirë profesionalisht dhe gjeografikisht për t'i ofruar mbështetje profesionale publikut rreth kompletimit dhe dorëzimit të Kërkesës për hetime të OAK-së,

Prandaj ne jemi të bindur se, me udhëzimin dhe mbështetjen aktive të Komisionit Disiplinor të OAK-së, zyrat rajonale të ANFJ-së posedojnë sfondin e duhur profesional dhe aftësitë e kërkuaara për zbatimin e përgjegjësive që rrjedhin nga ky memorandum mirëkuptimi.

**Neni I**

### **Objektivi**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (MiM) përcakton bashkëpunimin në mes të OAK-së dhe ANFJ-së në ndërmarrjen e përpjekjeve të përbashkëta, në përputhje me mandatet ose misionet e tyre përkatëse për të përmirësuar qasjen e publikut në sistemin disiplinor të OAK-së, dhe për të përmirësuar cilësinë e Kërkesave të pranuara nga publiku për hetime të OAK-së.

## Neni II

### Palët në memorandum

1. Palët në këtë marrëveshje janë ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS (në tekstin e mëtejmë - OAK) dhe AGJENSIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS (në tekstin e mëtejmë - ANJF), 2. OAK dhe ANJF bien dakord të bashkëpunojnë për të përbashkëtë përgjegjësitë e tyre të përbashkëta dhe detyrimet reciproke, duke e ruajtur identitetin e tyre.

## Neni III

### Vlerat e bashkëpunimit

Palët do të:

- a) Funksionojnë përbrenda mandateve të tyre
- b) Promovojnë tolerancën dhe mirëkuptimin
- c) Bashkëpunojnë në përcaktimin e veprimeve për arritjen e qëllimit të këtij memorandumi

## Neni IV

### Përgjegjësitë e palëve

#### 1. Përgjegjësitë e OAK:

- a) Koordinon punën dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve të kësaj marrëveshjeje. Kjo do të arrihet përmes Zyrës Disiplinore të OAK-së (ose Zyrës së ardhshme të Prokurorit Disiplinor - ZPD).
- b) Ofron dhe organizon trajnimet për zyrtarë të ANJF-së mbi temat përkatëse si:
  - a. Ligji për Avokatinë,
  - b. Kodin etik dhe profesional të sjelljes së avokatëve dhe,
  - c. Rregullorja e Kosovës mbi Procedurën disiplinore.
- c) Certifikimi i zyrtarëve të ANJF për vijimin e trajnimeve të lartpërmendura.
- d) Këshillon të gjitha palët që kërkojnë asistencë në plotësimin e formularit të OAK-së "Kërkesë për Hetim" për të adresuar ANJF për këtë qëllim.
- e) Informon me shkrim të gjitha institucionet përkatëse rrëth këtij MiM dhe për qëllimet e tij, duke përfshirë të gjitha gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë, si dhe Avokatin e popullit të Kosovës;

- f) Zhvillon një fushatë të informimit publik duke informuar opinionin për mbylljen e zyrave të veta rajonale dhe rrëth përmbajtjes përkatëse të këtij Memorandumi të mirëkuptimit.
- g) Ofron për ANJF furnizimin me të gjithë Formularët përkatës të OAK-së si dhe me materiale udhëzuese për shpërndarje në të gjitha zyrat e tyre përkatëse në terren në Kosovë.
- h) Pranon të gjitha kërkesat për hetim që ANJF merr nga qytetarët.

## **2. Përgjegjësitë e ANJF:**

1. Ofron për të gjithë personat të cilët paraqiten në Zyrat rajonale për Ndihmë Juridike Falas-ZRNJ dhe Zyrën Qendrore të ANJF-së formularët Kërkesë për hetim dhe materiale udhëzuese tjera përkatëse të ofruara nga ana e OAK-së.
2. Pranon, regjistron dhe dorëzon në Zyrën Disiplinore të OAK-së të gjitha Kërkesat e plotësuarë për hetim që arrijnë në Zyrat Rajonale për Ndihmë Juridike Falas dhe në Zyrën Qendrore të ANJF.
3. Nëse një palë që ankohet për sjellje të gabuar të avokatit, është përfitues i ndihmës juridike falas dhe I plotëson kriteret e parapara me Ligjin 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, atëherë ANJF do të:
  4. 4.1. Pranon palën dhe do dëgjon natyrën e ankesës,
  - 4.2. Në rast se zyrtari i ANJF-së e sheh ankesën si të arsyeshme, do të ndihmoj palën që të plotësoj formularin Kërkesë për hetime kundër avokatit/jo-avokatit,
  - 4.3. Në rast se Zyrtari i ANJF e konsideron ankesën e klientit si të pabazë apo të gabuar, këshillon palën rrëth mjeteve tjera juridike që mund të jenë në dispozicion, e regjistron rastin dhe njofton Zyrën disiplinore të OAK-së në lidhje me veprimin që është ndërmarrë.
  - 4.4. Ofron përfaqësim të denjë për palën gjatë të gjitha procedurave para komisioneve disiplinore të OAK-së.
5. Nëse ANJF konsideron se pala nuk I plotëson kriteret e parapara me Ligjin 04/L-017 për Ndihmë Juridikë Falas dhe megjithatë ka nevojë apo kërkon ndihmë në plotësimin e formularit Kërkesë për hetime, atëherë zyrtarët e ANJF-së do të këshillojnë palën për t'iu drejtar QNLZh-së.
6. Zyrtarët e ANJF-së janë të detyruar të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga OAK-ja mbi këto tema: Ligji për Avokatinë, Kodin etik dhe profesional të sjelljes së avokatëve dhe Rregullorja për Procedurën Disiplinore të OAK-së.

**Neni V**

**Modifikimi i marrëveshjes**


Çdo ndryshim i këtij memorandumi mund të bëhet me marrëveshje reciproke.

**Neni VI**

**Nënshkrimet**


Kjo marrëveshje është bërë në fryshtë e mirëbesimit dhe bashkëpunimit në mes të gjitha palëve.

**Nënshkruesit e kësaj Marrëveshje:**



Av. Ibrahim Z. DOBRUNA, Kryetar

Oda e Avokateve të Kosovës



Ramadan Gashi, Drejtor

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

09 Qershor 2014